FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 44	2000	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr.660, datë 13.12.2000	Për shitje trualli Selisë së Arqipeshkvisë	1983
Vendim i KM nr.663, datë 13.12.2000	Për dhënie emri Akademisë së Policisë së Shtetit	1983
Vendim i KM nr.664, datë 13.12.2000	Për miratimin e planit të veprimit, për përmirësimin e treguesve tekniko-financiarë të KESh, sha-së	1983
Vendim i KM nr.704, datë 21.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.129, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", ndryshuar me vendimin nr.4, datë 12.1.2000, të Këshillit të Ministrave	1984
Vendim i KM nr.719, datë 21.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.129, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"	1985

V E N D I M
Nr. 660, datë 13.12.2000

PËR SHITJE TRUALLI SELISË SË ARQIPESHKVISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5, 6 dhe 8, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Arqipeshkvisë Tiranë-Durrës t'i shitet një sipërfaqe trualli prej 8 500 m2, që ndodhet në qytetin e Tiranës, në rrugën "Zhan d'Ark", prapa hotel "Dajtit", ku është ndërtuar kompleksi i katedrales së Shën Palit dhe selia e kësaj arqipeshkvie, sipas sheshit dhe lejes së ndërtimit, të miratuar nga KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës.
2. Çmimi shitjes së truallit të jetë 800 lekë për m2.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 663, datë 13.12.2000

PËR DHËNIE EMRI AKADEMISË SË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Akademisë së Policisë së Shtetit t'i jepet emri "Akademia e Policisë Arben Zylyftari".
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 664, datë 13.12.2000

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT, PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TEKNIKO-FINANCIARË TË KESH, SHA-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 7962, datë 13.7.1999, "Për energjinë elektrike", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të veprimit, për përmirësimin e treguesve tekniko-financiarë, të KESH, sha-së.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për përgatitjen e akteve, ligjore e nënligjore, në përputhje me këtë plan veprimi.

3. Vendimi nr. 555, datë 23.10.2000, i Këshillit të Ministrave, "Për planin e veprimit për plotësimin e treguesve tekniko-financiarë të KESH, sha-së", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 704, datë 21.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.129, DATË 18.3.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.4, DATË 12.1.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 dhe 21, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në Kreun IV të vendimit nr.129, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet për pajisjen me leje tregtimi", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet si vijon:

"6. Subjektet, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, do të pajisen me leje tregtimi të përkohshme, deri në plotësimin e kushteve për depozitat.".

2. Në pikën 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pas fjalëve "subjektet që kryejnë aktualisht veprimtarinë", shtohen fjalët "në tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj".

- Pas paragrafit të parë të shtohen dy paragrafe, me këtë përmbajtje:

"Bëjnë përjashtime nga ky afat, shoqëritë anonime të tregtimit me shumicë, që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi për depozitat e karburanteve, në portin e Durrësit.

Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe i kalibrimit të tyre, duhet të plotësohet brenda 18 muajve pas fillimit të zbatimit të mastërplanit, në territorin e depozitave të karburanteve, në portin e Durrësit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.719, datë 21.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.129, DATË 18.3.1999, TË

KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 dhe 21, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 7, të vendimit nr.129, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, pas paragrafit III, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse e të kalibrimit të tyre, duhet të plotësohen nga subjektet, që kryejnë veprimtarinë e tregtimit të gazit të lëngshëm, sipas nenit 14, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, deri më datë 31.12.2001. Me plotësimin e këtyre kushteve jepet leja e tregtimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 29.12.2000
Doli nga shtypi më 29.12.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë